



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1240/22

Nr. i fq. / Br. sh _____

Data: / Datum 05.10.2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, neni 44 paragrafi 2 i Rregullores (QRK) Nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe nenin 67 "f" dhe "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M


PËR THEMELIM TË KOMISIONIT PËR RIINTEGRIM TË PERSONAVE TË RIATDHESUAR

1. Themelohet Komisioni për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar në Komunën e Vushtrrisë në këtë përbërje:
 - 1.1 znj. Kimete Mehana, Qendra për Punë Sociale, kryesuese e komisionit
 - 1.2 znj. Fitore Hyseni, Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare,
 - 1.3 znj. Fitore Krasniqi, zyrtare e Arsimit, anëtare,
 - 1.4 z. Ekrem Merovci, Koordinator për Kthim dhe Riatdhesim, anëtar
 - 1.5 z. Mentor Jashari, Drejtorja për Shërbime Publike, anëtar
 - 1.6 z. Ahmet Shuku, Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
 - 1.7 z. Sami Ibishi, Drejtorja për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, anëtar,
 - 1.8 z. Xhavit Mehmeti, Zyrtar për Integritim Evropian, anëtar,
 - 1.9 znj. Remzije Zekolli, Zyra për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, anëtare,
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi është organ vendimmarrës i cili shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave të riatdhesuar të Komunës së Vushtrrisë për përfitim nga skemat e riintegritimit. Komisioni gjatë punës së tij do të merr vendime duke i zbatuar dispozitat e nenit 44 paragrafi 4-9 të Rregullores (QRK) Nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar.
3. Komisioni në fjalë, për punën e tij duhet t'i paraqet raport me shkrim Kryetarit të Komunës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



vendimi i dërgohet

- Anëtarëve të komisionit
- Arkivit të sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, dhe nenin 2 të Rregullores (KKV) Nr.01/22, nr. protokollit 157/22, datë 30.06.2022 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (KKV) Nr. 03/2020 datë 27.02.2020 për Përkrahjen e Fermerëve në Bujqësi dhe Bizneseve në Sektorin Privat. Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet subvencionimi i fermerëve të Komunës së Vushtrrisë me nga 0.05 € (pesë cent) për litër qumësht të dorëzuar në pikat grumbulluese ose direkt në qumështore.
2. Pagesa të bëhet për 101 (njëqindnjë) fermer të komunës së Vushtrrisë të cilët janë të përfshirë në listën e Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, bashkëngjitur në shtojcë të këtij vendimi e që janë përfitueseve të këtij subvencioni.
3. Pagesa sipas të këtij vendimi të bëhet nga mjetet buxhetore (subvencione dhe transfere) të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Kryetari i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivitet të Sekretarisë.



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1245 / 22

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 05.10.2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPubLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 67, “g” të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KËSHILLIT ORGANIZUES

1. Formohet Këshilli Organizues për shënimin e “Festivalit të Patates”, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Medina Bunjaku**, - kryesuese
 - 1.2 **Ergin Sunguri**, anëtar
 - 1.3 **Gëzim Saraçi**, anëtar
 - 1.4 **Fazli Muharremi**, anëtar
 - 1.5 **Albiona Isa**, anëtar
 - 1.6 **Fatmir Feka**, anëtar
2. Këshilli organizues në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin e shënimit në këtë vit të “Festivalit të Patates” në Komunën e Vushtrrië.
3. Kryesuesi i Këshillit Organizues do të raportoj te kryetari i komunës lidhur me përgatitjet dhe mbarëvajtjen e këtij festivali.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit Organizues
- Arkivit të Sekretarisë.